



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202200834/5

Tiranë ___/___/2022

Lënda : *Rekomandim për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të huaj të parregullt në Republikën e Shqipërisë*

MINISTRISË SË BRENDSHME
Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTIT PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Tiranë

DREJTORISË VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Tiranë

QENDRËS SË MBYLLUR PËR TË HUAJT
Karreç

Në institucionin e Avokatit të Popullit në datën 14.06.2022 kanë bërë ankesë shtetasit irakianë O.D., i datëlindjes 22.11.1997, A.U., i datëlindjes 10.01.1998 dhe N.S., i datëlindjes 07.08.1994, të cilët janë përfaqësuar nga avokate N.V. (Pelliccione), anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë. Sipas ankuesve, repektivisht:

1. O.D., i lindur më 22.11.1997, në Anbar, Irak. Ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në muajin nëntor 2018 nga Greqia. Ka aplikuar për azil në Drejtorinë e Azilit dhe të Shtetësisë në Tiranë dhe ka qëndruar në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Azilkërkuesve (QKPA) në Babrru. Pas pranimit të kërkesës për azil ai është

larguar nga QKPA Babrru dhe është vendosur në një apartament në Tiranë së bashku me shtetasit Nezar Al Sammarraie dhe A.U.. Në muajin gusht 2019, është pajisur me leje qëndrimi dhjetëvjeçare nga Zyra e Migracionit dhe Kufirit Tiranë. Fillimisht ai është punësuar në një Call Center në Tiranë për rreth 9 muaj, dhe më pas ka mundur të punësohet në një kompani që prodhonte qese plastike në Vorë. Në datën 03.12. 2020 së bashku me 2 miqtë e tij të përmendur më sipër është arrestuar nga policia e Tiranës për shkaqe ende të panjohura.

2. A.U., i lindur më 10.01.1998, në Nasiriyah, Irak. Ka hyrë në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet Malit të Zi në muajin shtator të 2017. Në muajin dhjetor 2017 ka kërkuar azil në Korçë. Ai ka jetuar në QKPA në Babrru për dy muaj. Më pas është larguar nga QKPA Babrru dhe ka banuar me një shoqen e tij në Korçë. Në muajin maj 2018 është pajisur me kartën e azilantit në Republikën e Shqipërisë, më pas ai ka marrë leje qëndrimi dhjetëvjeçare. Në muajin maj 2019 është transferuar në Tiranë duke banuar në të njëjtin apartament me dy miqtë e tij dhe është punësuar në një Call Center për 9 muaj. Në vijim është punësuar në një kompani prodhimi të qeseve plastike në Vorë. Në datën 03.12.2020 është arrestuar nga policia së bashku me të dy miqtë e tij O.D. dhe Nezar Al Sammarraie për shkaqe ende të panjohura.

3. Nezar Al Sammarraie, lindur më 07.08.1994, në Bagdad, Irak, është diplomuar në fakultetin juridik ku më pas ka punuar si jurist. Ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në datën 02.10.2017 nëpërmjet Greqisë. Ka aplikuar për azil në Tiranë ndërkohë që jetonte në QKPA në Babrru dhe i është dhënë statusi i azilantit në RSH-së në datën 15.03.2018. Në datën 03.09.2018 është larguar nga QKPA Babrru dhe ka filluar të banojë në një apartament në Tiranë të marrë me qira nga ai dhe dy miqtë e tij të sipërpërmendur. Në datën 05.03.2019 është punësuar nga Shoqata e Refugjateve “RMSA”. Në shtator të vitit 2020 është takuar me një person që i është prezantuar si oficer i policisë sekrete, i cili ka kërkuar ta infiltrojë atë si spiun ndaj bashkëatdhetarëve të tij duke e kërcënuar se nëse nuk do të bashkëpunonte do ta dëbonte nga territori i RSH-së. Ai nuk ka pranuar të bëjë infiltruesin dhe i ka bllokuar numrin këtij personi. Por për shkak të kësaj situate në datën 03.12.2020 forcat e policisë e kanë marrë atë dhe 2 miqtë e tij në banesën ku ata banonin duke i dërguar në Komisarriatin e Policisë Nr. 2, Tiranë, pa u sqaruar motivin e arrestimit, i kanë detyruar të zgjidhnin një vend tjetër përveç Shqipërisë duke u komunikuar që ata nuk mund të vazhdonin të jetonin më në RSH-së. E gjithë kjo procedurë është zhvilluar pa pjesëmarrjen e një përkthyesi të gjuhës arabe. Sipas tij, oficeri i policisë sekrete i ka kërkuar të akuzonin një bashkëatdhetar të tyre si terrorist në Irak dhe në këmbim “do të grisnin të gjithë aktet e hetimit të nisur ndaj tyre”. Por ata nuk kanë pranuar një gjë të tillë dhe për këtë shkak janë dërguar në Qendrën e

Mbyllur për të Huajt (QMH) Karreç duke i penguar për 1 muaj që të kontaktonin të afërmit e tyre si dhe ndonjë avokat.

Më tej, Ministri i Brendshëm në datën 07.12.2021 me shkresat nr. prot. 374; 375; 376 ka nxjerrë Urdhrat e Dëbimit të tyre si persona të padëshiruar për RSH-së “*non grata*”. Këto urdhra, për arsye të panjohura nuk janë ekzekutuar deri më tani.

Sipas ankuesve, në nenin 105 të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt” parashikohet se:

“1. I huaji i shpallur person i padëshiruar dëbohet nga territori i Republikës së Shqipërisë me urdhër dëbimi, të nxjerrë nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

2. Urdhri i dëbimit si person i padëshiruar i njoftohet në formë të shkruar të huajit në gjuhën që kupton ose së paku në gjuhën angleze dhe përmban:

a) të dhënat personale të personit të dëbuar;

b) arsyet për të cilat është nxjerrë urdhri i dëbimit;

c) periudhën e ndalimit të hyrjes në Shqipëri;

ç) në rast ripranimi, shtetin ku do të kryhet ky ripranim;

d) datën e largimit;

dh) mënyrën e ekzekutimit;

e) pikën e kalimit kufitar nga do të largohet.”

Të gjitha këto kërkesa të ligjit janë të specifikuar në urdhrin e dëbimit të nxjerrë nga Ministri i Brendshëm, por këto urdhra dëbimi nuk janë zbatuar ende nga Policia e Shtetit shqiptar.

Gjithashtu në këtë ankesë ata shkruajnë se, deri në muajin qershor 2022, kur ata i janë drejtuar institucionit tonë, kanë plotësuar një periudhë kohore mbi 18 muaj që vazhdojnë të qëndrojnë në QMH në Karreç, duke tejkaluar të gjithë afatet që parashikon ligji “Për të huajt”, respektivisht në nenin 117/1/2 të tij.

Gjithashtu ankuesit shkruajnë se, mbajtja e tyre në QMH në Karreç është shkelje e të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e RSH-së, në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut¹ dhe në Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-së.

¹ Neni 5 i Konventës: “E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit” parashikon se:

“1. Çdo njeri ka të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit. Askush nuk privohet nga liria përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:

a. ndalimi i ligjshëm i një personi pas dënimit nga një gjykatë kompetente;

b. arrestimi ose ndalimi i ligjshëm i një personi për mospërbushjen e urdhërimit të ligjshëm të një gjykate ose për të garantuar zbatimin e ndonjë detyrimi të parashikuar me ligj;

Ndërkohë ata shkruajnë se QMH në Karreç, është një qendër e mbyllur e cila i ka të gjitha elementët e sigurisë së një institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale, edhe pse nuk klasifikohet si e tillë nga ligji. Sipas ankuesve, kjo do të thotë që ata nuk mund të qendrojnë në një qendër të mbyllur me kufizim lirie dhe nivel të caktuar sigurie duke qenë se ndaj tyre nuk ka asnjë vendim gjykate që të ketë vendosur privimin e tyre nga liria.

Po ashtu, ata shkruajnë se ndodhen përpara faktit që ndaj tyre nuk mund të zbatohet “*urdhri i dëbimit*” pasi ata nuk mund të rikthehen në vendin e tyre të origjinës për shkak se shteti i tyre nuk garanton asnjë lloj garancie në bazë të Drejtës Ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e tyre dhe se kthimi i tyre në shtetin e origjinës do të thotë shkelje e të drejtave të njeriut, të parashikuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe kryesisht nga Konventa e Gjenevës e vitit 1951 dhe protokolli shtesë i saj i vitit 1967, të cilat janë të ratifikuara edhe nga RSH-së. Në dijeninë e tyre, Iraku është një shtet që akoma bën pjesë në kategorinë e shteteve që e Drejta Ndërkombëtare u njeh ende mbrojtjen ndërkombëtare.

Përveç sa më sipër, ankuesit shkruajnë se për këtë shqetësim i janë drejtuar edhe Ministrisë së Brendshme, por ende nuk kanë marrë përgjigje (bashkëlidhur me ankesën na kanë dërguar edhe kopjen e shkresës drejtuar Ministrisë së Brendshme në datën 26.05.2022).

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese ne iu drejtua Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme dhe u kërkua informacion lidhur me sa më poshtë vijon:

1. A qëndrojnë pretendimet e shtetasve irakianë O.D., A.U. dhe N.S., se ata po mbahen për më shumë se 18 muaj në QMH në Karreç dhe në kundërshtim me nenin 117/2 të ligjit “Për të huajt”?
2. Nëse po, cili është shkak dhe baza ligjore e mbajtjes së tyre në QMH Karreç tej afatit maksimal ligjor deri në 12 muaj?

c. arrestimi ose ndalimi i ligjshëm i një personi i bërë me qëllim që ai të sillet para një autoriteti ligjor kompetent në bazë të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një shkelje të ligjit ose kur konsiderohet arsyeshmërisht e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të një shkeljeje ose largimin e tij pas kryerjes së shkeljes; ...

5. Çdo njeri që ka qenë viktimë e arrestimit ose e ndalimit në kundërshtim me dispozitat e këtij Neni ka të drejtë të zbatueshme për kompensim.”

3. Çfarë veprimesh janë kryer nga strukturat tuaja për dëbimin/largimin e këtyre shtetasve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në zbatim të urdhrave të dëbimit të nxjerrë nga strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe Ministri i Brendshëm.

4. Cili është qëndrimi juaj lidhur me pretendimin e ankuesve se nuk u është kthyer përgjigje e kërkesës së tyre dërguar Ministrisë së Brendshme në datën 26.05.2022?

Bashkë me informacionin u kërkuam që të na dërgonin edhe fotokopje të dokumentacionit që lidhet me këtë ankesë.

Deri më tani nuk na është kthyer përgjigje nga institucionet që iu jemi drejtuar, ndonëse afati ligjor për kthimin e tyre ka kaluar. Theksojmë se moskthimi i përgjigjeve të kërkuara ka sjellë si pasojë moskorrektesën e institucionit tonë ndaj ankuesve për shqyrtimin e ankesave të tyre brenda afatit ligjor. Ndërkohë si rrjedhojë e kësaj është cenuar edhe reputacioni i institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Ju bëjmë me dije se detyrimi i organeve dhe funksionarëve publik për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit është parashikuar në nenin 63/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 19/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar. Ndërsa në nenin 22/1 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, “Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit” të ligjit organik, parashikohet se:

“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.”

Mosdërgimi nga ana juaj i përgjigjes së kërkuar, përbën një rast tipik të mosbashkëpunimit të organeve të administratës publike me institucionin kushtetues të Avokatit të Popullit. Sqarojmë se për arsye të emergjencës që paraqet rasti në shqyrtim, kjo çështje do të trajtohet më vete nga institucioni ynë.

Ndërkohë nga QMH Karreç me shkresën nr. 736/1 prot., datë 18.07.2022, ndërmjet të tjerave u informuam se, tre shtetasit e huaj irakianë O.D., i lindur më 22.11.1997, A.U. i lindur më 10/01/1998 dhe Nezar Al Sammarraie, lindur më 07.08.1994, janë akomoduar pranë kësaj qendre në datën 03.12.2020.

Shtetasi Nezar Al Sammarraie është akomoduar për herë të parë në QMH Karreç në datën 26.11.2017 me urdhër ndalimi nr. 14, datë 26,11.2017 dhe urdhër dëbimi nr. 15, datë 26.11.2017, lëshuar nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës. Në datën 20.12.2017, ky shtetas është transferuar në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Azilkërkuesve në Babru, Tiranë, pas kërkesës së tij dhe me miratimin e Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë të RSH-së. Po kjo drejtori me vendimin nr. 22, datë 09.12.2020 ka refuzuar statusin e mbrojtjes plotësuese të tij në RSH-së. Sipas QMH Karreç, nga informacioni i dërguar nga Drejtoria Kufitare dhe Migracionit Tiranë rezulton se edhe për të dy shtetasit e tjerë irakianë është revokuar statusi i mbrojtjes plotësuese dhe i lejes së qëndrimit në RSH-së. Gjithashtu u informuam se me shkresën nr. 1085, datë 03.12.2020, të strukturave të hetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, QMH Karreç është informuar se këta shtetas janë përfshirë në veprimtari kriminale dhe prania e tyre në vendin tonë përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë kombëtare.

Bazuar në ligjin “Për të huajt” nr. 108/2013 dhe Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 293, datë 04.06.2015, Kreu VIII, Pika 8, nga QMH Karreç i është dërguar informacion DVKM Tiranë lidhur me praktikën e tre shtetasve të huaj irakianë të cilët plotësonin afatin e qëndrimit një vjeçar në këtë qëndër.

Në datën 03.12.2021, këta shtetas kanë plotësuar afatin një vjeçar të qëndrimit në QMH Karreç dhe po në këtë datë këta shtetas janë transferuar në DVKM Tiranë. Brenda kësaj date pranë DVKM Tiranë janë kryer procedurat në bazë të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 656/2, datë 01.12.2021, për shpalljen e tyre si “Persona të padëshiruar” në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pas kësaj janë rilëshuar tre urdhra ndalimi për mbylljen e tyre në QMH Karreç përkatësisht me nr. 483, 484, dhe 485, datë 03.12.2021.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se gjatë intervistimit të bërë nga punonjësit e QMH Karreç në datën 14.04.2022, ata janë shprehur se duan që të largohen për në Gjermani për shkak të lidhjeve që kanë në këtë shtet dhe në pamundësi kërkojnë të largohen në mënyrë vullnetare nga territori i RSH-së.

Përveç sa më sipër QMH Karreç na vuri në dijeni se aktualisht këta shtetas janë të ndaluar në këtë qëndër dhe ndodhen në pritje të përfundimit të procedurave ligjore në zbatim të ekzekutimit të urdhër dëbimeve të tyre nga strukturat përgjegjëse sipas ligjit të nr. 79/2021 “Për të huajt”, specifikisht neni 106/1.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese të përgjigjes së dërguar nga QMH Karreç, si dhe verifikimit të dokumentacionit të bërë nga ana jonë pranë kësaj qendre rezulton se:

1. Shtetasit e huaj irakianë N.S., O.D. dhe A.U., kanë hyrë në territorin e RSH-së në mënyrë të parregullt gjatë viteve 2017-2018. Pas kësaj dhe mbi bazën e kërkesës drejtuar Drejtorisë për Azilin dhe Shtetësinë atyre u është dhënë statusi i azilantit dhe leja e qëndrimit në territorin e RSH-së. Në datën 03.12.2020 nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit (DRKM) Tiranë janë nxjerrë urdhrat e ndalimit të tyre në QMH Karreç, respektivisht me nr. 289, 290 dhe 291, datë 03.12.2020. Me shkresën nr. 1806 prot., datë 04.12.2020, DRKM Tiranë informon QMH Karreç mbi arsyet e ndalimit të tre shtetasve irakianë. Sipas përmbajtjes së kësaj shkrese rezulton se kjo drejtori me shkresën nr. 1085, datë 03.12.2020 të strukturave të hetimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është vënë në dijeni se këta shtetas janë përfshirë në veprimtari kriminale dhe prania e tyre në vendin tonë përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë kombëtare. Gjithashtu DRKM Tiranë informon QMH Karreç se ndaj këtyre shtetasve ka filluar procedura për heqjen e statusit të azilantit, anulimin e lejes së qëndrimit dhe shpalljen e tyre “Persona të padëshiruar”².

Në vijim, në datën 28.12.2020 nga DRKM Tiranë është bërë refuzimi/heqja e lejeve të qëndrimit për arsye se “Nuk ekzistojnë arsyet për të cilat është lëshuar leja e qëndrimit (neni 35/c,d të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”” dhe se “Përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike (neni 63/c,d të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”)³”. Pas kësaj situatë ndaj tyre nga DRKM Tiranë janë nxjerrë urdhrat e dëbimit nr. 1, 2 e 3, datë 06.01.2021 për arsye se “Nuk plotëson kushtet e nevojshme për qëndrim referuar nenit 109/d të ligjit “Për të huajt”” dhe ndalim hyrjeje në RSH-së deri në datën 05.01.2026.

Me shkresën e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin nr. 1836/1 prot., datë 01.06.2021, drejtuar QMH Karreç, është bërë zgjatja e afatit të qëndrimit të tyre në këtë qendër në bazë të kërkesës së kësaj të fundit edhe për 6 muaj të tjerë, por jo më shumë se një vit qëndrimi nga dita e parë e ardhjes nëse nuk mbahen për arsye të tjera ligjore.

Me shkresën nr. 536 prot., datë 15.11.2021, QMH Karreç ka informuar DRKM Tiranë se këta tre shtetas në datën 03.12.2021 plotësojnë afatin maksimal të qëndrimit në këtë qendër. Për këtë arsye i kërkojnë marrjen e masave për

² Çështja që lidhet me heqjen e statusit të azilantit, anulimin e lejeve të qëndrimit dhe shpalljen e tyre “Persona të padëshiruar”, shkaqeve ligjorë dhe arsyetimi i vendimeve përkatëse do të vijojnë të jenë objekt i një hetimi tjetër administrativ nga Avokati i Popullit.

³ Sqarojmë se në periudhën kohore që janë realizuar procedurat, për të cilat kanë paraqitur shqetësimin ankuesit ka qenë në fuqi ligji nr. 108/2013 “Për të huajt”, i cili aktualisht është shfuqizuar me ligjin nr. 79/2021, që është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, datë 18.10.2021 dhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2021.

zëvendësimin e masës së ndalimit në QMH me atë të “Të detyrimit të qëndrimit në një territor të caktuar”.

Në datën 03.12.2021, këta shtetas kanë plotësuar afatin një vjeçar të qëndrimit në QMH Karreç, ndaj ndodhur në këto rrethana nga kjo qëndër janë nxjerrë urdhër largimet nga qëndra të këtyre shtetasve respektivisht me nr. 440, 441 dhe 442 datë 03.12.2021. Pas nxjerrjes së urdhrave të cituar më sipër, shtetasit e huaj nuk janë lënë të lirë por janë transferuar në DVKM Tiranë. Po në datën 03.12.2021 nga DVKM Tiranë janë nxjerrë tre urdhra ndalimi për mbylljen e tyre në QMH Karreç, përkatësisht me nr. 483, 484, dhe 485, datë 03.12.2021, për arsye se janë subjekt i një urdhri dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë si “Person i padëshiruar”, të nxjerrë nga Ministri i Brendshëm në datën 01.12.2021.

2. Zgjatja e afatit të qëndrimit të tyre në QMH Karreç edhe për 6 muaj të tjerë me shkresën nr. 1836/1 prot., datë 01.06.2021, të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin është e pabazuar dhe e paargumentuar, konkretisht nuk qartësohet se çfarë procedurash janë kryer për largimin e të huajve nga territori i RSH-së, cilat kanë qenë arsyet që kanë bërë të pamundur largimin e tyre, sikurse parashikohet në pikën 2, gërmat “a”, “b” dhe “c” të nenit 123⁴ të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”. Përveç mangësive të përshkruara më sipër, ky akt administrativ nuk është nxjerrë në përputhje me nenin 123/3, sepse zgjatja e periudhës së ndalimit duhej bërë me

⁴ Neni 123 “Periudha e ndalimit në qëndër të mbyllur” parashikon se:

1. I huaji mbahet në qëndër të mbyllur për një periudhë maksimale deri në 6 muaj.

2. Autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, me propozim të autoritetit të qendrës së mbyllur, zgjat periudhën e ndalimit në qëndër të të huajit deri në 6 muaj të tjerë, nëse brenda periudhës 6-mujore të ndalimit, largimi i të huajit ka qenë i pamundur për arsye se:

a) i huaji refuzon të japë të dhëna apo informacione personale, si dhe dokumente udhëtimi të nevojshme për kthimin e tij ose jep informacione të rreme;

b) i huaji ka penguar apo bllokuar kthimin e tij në forma të ndryshme;

c) vonesa në lëshimin e dokumentit të udhëtimit apo ndonjë dokumenti tjetër të nevojshëm për kthim, kërkuar autoritetit të një vendi tjetër, është i justifikuar.

3. Kërkesa për shtyrjen e afatit të qëndrimit nga autoriteti i qendrës së mbyllur bëhet së paku 15 ditë përpara mbarimit të afatit 6-mujor të ndalimit në qëndër. Autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin shqyrton kërkesën dhe njofton autoritetin e qendrës së mbyllur **për vendimin e marrë brenda afatit 10-ditor.**

4. Gjatë kohës së ndalimit në qëndrën e mbyllur, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, në bashkëpunim me autoritetin e qendrës së mbyllur, shqyrton ekzistencën e kushteve për të mbajtur të mbyllur në qëndër të huajin e ndaluar. Në varësi të vlerësimit të situatës, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin mund të vendosë për zëvendësimin e masës së ndalimit në qëndër me masa të përshtatshme të përkohshme të përcaktuara në këtë ligj.

5. Në rast se i huaji kryen një vepër penale gjatë kohës së qëndrimit në qëndrën e mbyllur, ndaj tij fillon ndjekja penale, sipas dispozitave të legjislacionit penal në fuqi, dhe i huaji transferohet menjëherë në një institucion tjetër të ngritur për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi.

vendim, si dhe me nenet 99⁵ e 100⁶ të Kodi i Procedurave Administrative. Atij i mungojnë disa nga elementët e domosdoshëm të parashikuar në këto dispozita sikurse janë: *qëllimi, pjesa hyrëse (emri e organit publik që nxjerr aktin; palët të cilave u drejtohet akti; pjesa arsyetuese; e drejta e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit)*. Pjesa arsyetuese duhet të përmbajë: *shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti; shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave; dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast.*

3. Ndalimi i tre shtetasve irakianë në QMH Karreç nga DRKM Tiranë me urdhrat nr. 483, 484 dhe 485, datë 03.12.2021 është bërë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 117/2⁷ të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, sepse afati maksimal i mbajtjes së një shtetasi të huaj në këtë qendër është një vit. Gjithashtu, ndalimi i këtyre shtetasve në QMH Karreç nuk është bërë në përputhje me nenin 115/1 të

⁵ Neni 99 “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik”

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.

2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

a) pjesën hyrëse, që përmban:

i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;

ii) palët të cilave u drejtohet akti;

iii) datën e miratimit;

iv) bazën ligjore;

b) pjesën arsyetuese;

c) dispozitivin që tregon:

i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;

ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;

iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.

⁶ Neni 100 “Arsyetimi i aktit”

Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:

a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;

b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;

c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;

ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.”

⁷ Neni 117 “Periudha e ndalimit në qendër të mbyllur” parashikon se:

“1. I huaji mbahet në qendër të mbyllur për një periudhë maksimale deri në 6 muaj.

2. Autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, me propozim të autoritetit të qendrës së mbyllur, zgjat periudhën e ndalimit në qendër të të huajit deri në 6 muaj të tjerë nëse brenda periudhës 6-mujore të ndalimit, largimi i të huajit ka qenë i pamundur për arsye se:

a) i huaji refuzon të japë të dhëna apo informacione personale, si dhe dokumente udhëtimi të nevojshme për kthimin e tij ose jep informacione të rreme;

b) i huaji ka penguar apo bllokuar kthimin e tij në forma të ndryshme;

c) vonesa në lëshimin e dokumentit të udhëtimit apo ndonjë dokumenti tjetër të nevojshëm për kthim, kërkuar autoritetit të një vendi tjetër, është e justifikuar....”

ligjit nr. 79/2021⁸. Sipas këtij neni, ndalimi në qendrën e mbyllur të një shtetasi të huaj të parregullt në RSH-së është masa e fundit administrative që merret dhe ekzekutohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal për trajtimin e të huajve për të cilin është nxjerrë një urdhër dëbimi, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë ekzekutuar të gjitha masat e mundshme alternative.

Por nga dokumentacioni i administruar lidhur me rastin e marrë në shqyrtim nuk rezulton që ndaj tre shtetasve të huaj irakianë të sipërpërmendur të jenë dhënë dhe ekzekutuar masa të tjera alternative sikurse parashikohet në Seksionin IV të këtij ligji, respektivisht në nenet 109, 110, 111, 112 e 113, të cilat janë: *Detyrimi për t'u paraqitur në intervale të rregullta kohore pranë autoriteteve përgjegjëse rajonale për kufirin dhe migracionin; Bllokimi i biletës ose i dokumentit të udhëtimit; Bllokimi i mjeteve financiare ose vendosja e garancisë financiare; Qëndrimi i detyrueshëm në një territor të caktuar.*

Theksojmë se, në asnjë nga dispozitat e ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt” apo të ndonjë akti tjetër normativ ligjor ose nënligjor në fuqi në vendin tonë nuk parashikohet e drejta e strukturave përgjegjëse qendrore e rajonale për trajtimin e të huajve apo e strukturave të tjera të Policisë së Shtetit dhe të Ministrisë së Brendshme për të zgjatur afatin e ndalimit të një shtetasi të huaj në qendrën e mbyllur tej afatit maksimal një vjeçar.

Nëse ndaj këtyre shtetasve të huaj ka prova që janë përfshirë në veprimtari kriminale sikurse përshkruhet në informacionin e dërguar nga strukturat e hetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit DRKM Tiranë, të cilin e përshkruam më sipër, dhe prania e tyre në vendin tonë përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë kombëtare, nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit në

⁸ Neni 115 “Ndalimi në qendër të mbyllur”, parashikon se:

1. Ndalimi në qendrën e mbyllur është masa e fundit administrative që merret dhe ekzekutohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal për trajtimin e të huajve ndaj të huajit për të cilin është nxjerrë një urdhër dëbimi, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë ekzekutuar të gjitha masat e mundshme alternative, ose kur nga vlerësimi konsiderohet se këto masa nuk mund të zbatohen për të huajin, ose për të huajin e ripranuar, në bazë të marrëveshjeve të ripranimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me qëllim të vetëm sigurimin e kushteve për kthimin/ripranimin e tij.

2. *I huaji mbahet i ndaluar në qendër të mbyllur, të ngritur posaçërisht për këtë qëllim, në afate sa më të shkurtra kohore, derisa të kryhen procedurat ligjore, për të mundësuar largimin e tij nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.*

3. *Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal për trajtimin e të huajve mund ta ndalojë në qendër të mbyllur për arsye të sigurisë publike të huajin, identiteti apo arsyet e qëndrimit të të cilit nuk janë të qarta.*

4. *I huaji njoftohet në formë të shkruar, në gjuhën që kupton ose së paku në gjuhën angleze, për urdhrin e ndalimit në qendër të mbyllur, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën që të sigurojë mbrojtje ligjore me një avokat të zgjedhur prej tij ose kryesisht, si dhe të kontaktojë me të afërmit e vet.*

bashkëpunim me organin e prokurorisë duhet të aplikoheshin masat e sigurisë të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Sqarojmë se, sikurse është parashikuar në nenin 114 të ligjit nr. 79/2021, *Qendra e mbyllur është një institucion administrativ, me nivel të caktuar sigurie dhe kufizim lirie, në të cilin mund të vendosen vetëm të huajt që janë subjekt dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë*. Mbyllja e të huajve në këtë qendër duhet të bëhet mbi bazën e një vlerësimi rast pas rasti dhe jo për çdo shtetas të huaj të parregullt në vendin tonë dhe me qëllim realizimin e urdhrave të dëbimit të nxjerrë ndaj tyre, por jo, kurrsesi ndaj personave të përfshirë në veprimtari kriminale, sikurse është vepruar në rastin në fjalë. Pra, QMH Karreç nuk është dhe nuk duhet të përdoret si vend akomodimi për personat e përfshirë në veprimtari kriminale.

Ndodhur në këto rrethana faktike e ligjore, referuar nenit 109/d të Kodit të Procedurës Administrative⁹, rezulton se aktet administrative, tre urdhër ndalimet për mbylljen e tyre në QMH Karreç përkatësisht me nr. 483, 484, dhe 485, datë 03.12.2021, të nxjerra nga DRKM Tiranë, janë të paligjshëm sepse vijnë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 117/2 të ligjit material nr. 79/2021 “Për të huajt”.

4. Evidentohet qartë se nxjerrja e tre shtetasve irakianë nga QMH Karreç me urdhër largimet nr. 440, 441 dhe 442 datë 03.12.2021 të drejtuesit të kësaj qendre, nuk e ka ndërprerë periudhën kohore të mbajtjes së tyre mbyllur. Në fakt, ata në asnjë çast nuk kanë qenë të lirë por të shoqëruar me punonjës policie gjatë transferimit nga QMH Karreç, në DRKM Tiranë e cila ka nxjerrë tre urdhra ndalimi për mbylljen e tyre në QMH Karreç përkatësisht me nr. 483, 484, dhe 485, datë 03.12.2021 dhe sërish brenda të njëjtës datë janë rikthyer në QMH Karreç. Ne vlerësojmë se ky veprim është bërë me qëllim “legjitimimin” e ndalimit të tyre në këtë qendër për herë të tretë me arsyetimin e pambështetur në ligj se në këtë rast fillon një afat i ri ndalimi/mbylljeje.

⁹ **Neni 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ”**

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;
- d) është në kundërshtim me ligjin material;
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

5. Avokati i Popullit çmon se në rastin në fjalë ndaj tre shtetasve irakianë të cilët janë subjekte të urdhër dëbimeve nga territori i Republikës së Shqipërisë si “Person i padëshiruar”, të nxjerrë nga Ministri i Brendshëm në datën 01.12.2021, nga DRKM Tiranë duhet të aplikohet ndonjë prej masave alternative të parashikuara në nenet 109, 110, 111, 112 e 113 të ligjit nr. 79/2021, sikurse mund të ishte ajo e “Qëndrimit të detyrueshëm në një territor të caktuar”, deri në përfundim të procedurave të largimit të tyre nga territori i vendit tonë dhe jo mbyllja në QMH Karreç.

Është rasti që të sjellim në vëmendje se gjatë viteve të fundit në territorin e vendit tonë kanë hyrë me qëllim qëndrimi këtu apo kalim në vendet e BE-së një numër jo i vogël/i konsiderueshëm shtetasish nga vende të ndryshme, kryesisht nga Azia, të cilët largohen për shkak të varfërisë së tejskajshme, luftrave që i kanë përfshirë këto vende, etj. Ata krahas problematikave të tjera, mund të jenë të traumatizuar nga ngjarjet e rënda që kanë ndodhur në këto shoqëri apo në familjet e tyre. Ndodhur në këto rrethana, dhe shpesh herë pa të ardhura financiare e veshmbathje të nevojshme, duke lëvizur në këmbë e në terrene të vështira, të kequshqyer e pa gjumë dhe për më tepër kur nuk njohin as gjuhën tonë, ata meritojnë një përkujdesje të shtuar humane, veçanërisht nga strukturat shtetërore. Por pavarësisht kësaj, strukturat shtetërore kanë detyrimin ligjor që të respektojnë të gjitha të drejtat ligjore që atyre u garantohen nga Kushtetuta e RSh-së, Konventat Ndërkombëtare dhe aktet e tjera normative ligjore e nënligjore në fuqi në vendin tonë.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; në gjurmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, si dhe në nenin 21/c të këtij ligji, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për të bërë të mundur nxjerrjen sa më shpejtë të shtetasve irakianë N.S., O.D. dhe A.U. nga QMH Karreç.

2. Marrjen e masave të nevojshme për të analizuar këtë rast, nxjerrjen e shkaqeve të ndodhjes dhe përgjegjësitë përkatëse.

3. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e punonjësve të Policisë Kufitare dhe Migracionit me qëllim respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të huaj në vendin tonë dhe zbatimin me korrektësi, profesionalizëm dhe objektivitet të dispozitave të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, lidhur me rastet e mbylljes së shtetasve të huaj të parregullt në QMH Karreç. Të theksohet e sillet në vëmendje se kjo masë duhet të jetë e fundit dhe të bëhet mbi bazën e një vlerësimi rast pas rasti dhe pasi të jenë aplikuar masat e tjera alternative të parashikuara në këtë ligj.

4. Marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin e praktikës së deritanishme nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, që, në rastet e zgjatjes së afatit të qëndrimit mbi 6 muaj të shtetasve të huaj në QMH Karreç, të bëhet me vendim të arsyetuar dhe vetëm në rastet e parashikuara në nenin 117/2 të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt” si dhe të përfshijë të gjithë elementët e aktit administrativ sipas parashikimeve të neneve 99 e 100 të KPA.

5. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat rajonale të Policisë Kufitare dhe Migracionit në shkallë vendi me qëllim mos përsëritjen e tij në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi lutemi të na njoftoni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca